

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TE
THELLUAR TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE
MJEDIS PER AKTIVITETIN MINERAR**

**Zgjerim i sipërfaqes së shfrytëzimit gur gëlqeror me
karriere, Fshati Herraj, Njësia Administrative**

Zall Herr, Tiranë

(Sipas Ligjit nr.10 440 date 07.07.2011 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” *Kodi eshte 19*)



INVESTITOR : “IN CO” sh.p.k

PROJEKTUES : « STUDIO PROJEKT » shpk

Tiranë 2016

Permbajtja

HYRJE

1. INFORMACION PER QELLIMIN E VNM DHE METODIKEN E ZBATUAR

2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

3. NJE PERSHKRIM I ANALIZIMIT TE ALTERNATIVAVE TE MUNDSHME PER ZBATIMIN E PROJEKTIT OSE KOMPONENTEVE TE VECANTA TE TIJ (SI AKSESI RRUGOR, ADMINISTRIMI I MBETJEVE DHE UJERAVE TE NDOTURA , LLOJET E LENDEVE DJEGESE , VENDODHJA E PROJEKTIT ETJ) SI DHE SQARIMI I ARSYEVE KRYESORE PER ALTERNATIVEN E PROPOZUAR , DUKE MARR PARASYSH NDIKIMET NE MJEDIS TE SELICES ALTERNATIVE , SI DHE NE RAST SE KA MENDIMET DHE SUGJERIMET E INSTITUCIONEVE PERGJEGJESE QE MBULOJNE FUSHEN E ZBATIMIT TE PROJEKTIT.

4. NJE PERSHKRIM TE GJENDJES DHE VLERAVE EKZISTUESE TE MJEDISIT QE MUND TE NDIKOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR DUKE PERFSHIRE

5. NJE PERSHKRIM TE NDIKIMEVE NEGATIVE TE RENDESISHME TE PROJEKTIT TE PROPOZUAR MBI MJEDISIN KU PERFSHIHEN

6. NDIKIMET NE MJEDISIN NDERKUFITAR TE PROJEKTIT

7. NDIKIMET POZITIVE NE MJEDISIN E ZONES SE PROJEKTIT

8. MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT NGA SECILI NDIKIM NEGATIV TE IDENTIFIKUAR

9. PROGRAMIN E MONITORIMIT TE NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTIT

10. PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE MJEDISIT

HYRJE

Shoqëria “IN CO” shpk është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër NIPT J62410017G ,datë 09/12/1996 për zhvillimin e Veprimtari te nxjerrjes, prodhimit, tregëtimit te mineraleve te ndryshme me shumice dhe pakice dhe import eksport, shfrytezimit te mineraleve te ndryshme te dobishme, shfrytezim dhe perpunim te stoqeve minerale dhe sterile, perdorim te lendeve plasese te perdorimit civil dhe shperthyese.

Subjekti “IN CO” shpk zoteron lejen minerare te shfrytëzimit nr. 1641 date 21.06.2013 si dhe lejen Mjedisore ne objektin Herraj, Zall Herr rrethi Tirane dhe ka marre nga Ministria e Energjië dhe Industrisë “*Njoftimin per fillim procedurash per zgjerimin e lejes minerare te shfrytezimit nr.1641,date 21.06.2013*” me nr, 36 47 Prot. date 04.07.2016 dhe dhe ka fituara te drejten e pergatitjes se dokumentacionit per aplikim per leje Mjedisore per minerale te grupit te materialeve te ndertimit gure gelqerore per prodhim inertesh.

Ne keto rrethana subjekti aplikoj ne Ministrine e Mjedisit me date 16.08.2016. per njoftimin e procedures se thelluar te VNM-se por me nje shkrese te te Ministrise Mjedisit me date 29.08.2016 me nr. 5386 Prot. ku na lajmeron qe ne duhet te aplikojme per procedure parapake te VNM –se dhe ne keto rrethana ne pergatitem dokumentat per te aplikuar.

Studimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis per aktivitetin minerar prodhim minerali gure gelqerore me kariere u pergatit me kerkese te subjektit “IN CO” shpk , ne zbatim te legjislacionit Shqiptar.

Raporti synon te jape nje informacion te detajuar dhe te besueshem lidhur me ndikimin mjedisor te projektit te propozuar ne perdorimin e tokes, efektet lidhur me ndikimet ne floren, faunen, burimet e ujit, emetimin e gazeve sere ne atmosfere, shkarkimet ne toke, uje, ndotjen akustike, si dhe çdo ndikim social ekonomik ne punesimin lokal, permiresimin e infrastruktures dhe ndikimeve te tjera te rendesishme mjedisore ose sociale, perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permisimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet :

-Marrjes ne konsiderate te çeshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se projektit.

-Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.

-Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit te aktivitetit minerar te prodhimit te mineralit ndertimor gurit gelqerore me kariere mbi mjedisin human.

-Analizen e faktoreve pozitive e negative mjedisore, percaktimin e masave zbutese per Reduktimin e ndikimeve negative.

-Nxjerrjes ne dukje dhe vlersimin cilesor te ndikimeve ne mjedis te projektit.

-Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt.

Projekti tenton permiresimin e vlerave ekologjike e rikrijuese te territorit, gjate shfrytezimit te tij , si qender rekreative e social- kulturore.

Per kete problem u be mbikqyrja e terrenit ne te gjithë zonen, duke kryer vrojtime te ndryshme , si dhe te biodiversitetit

1. INFORMACION PER QELLIMIN E VNM DHE METODIKEN E ZBATUAR

a-Pershkrim te qellimit dhe objektive te VNM

Shoqeria IN CO shpk

Vleresimi i ndikimit ne mjedis eshte nje proces ne vazhdimesi i aktivitetit dhe siguron se ndikimet mjedisore te rendesishme, sinjifikante jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim, zbatim te aktivitetit qe do te zhvillohet.

Qellimi i VNM- se

Qellimi i hartimit te raportit te VNM-se eshte percaktimi i efekteve negative dhe pozitive te aktivitetit dhe masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis si rezultat i zhvillimit te projektit te shfrytezimit te gurit gelqerore me kariere ne objektin Herraj, Njesia administrative Zall Herr ,Tirane

VNM nuk do te mbuloj çdo aspekt te nje efekti mjedisor te projektit, me te njejtin nivel detajesh. Theksi do te vihet ne ndikimet kryesore qe shkakton zhvillimi i aktivitetit.

Gjithashtu nje synim tjeter eshte te perkaktoje e rekomandoje masat teknike- organizative per zbutjen e aneve negative qe mund te krijohen gjate zvillimit te aktivitetit dhe te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te aktiviteteve te propozuara.

VNM perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet :

- Marrjes ne konsiderate te ndikimeve te mjedisit qe ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit ne mjedis te aktivitetit te hapjes, pergatitjes se karrieres dhe shfrytezimit me punime siperfaqsores te gurit gelqeror, mbi mjedisin human.
- Analizes se faktoreve pozitive e negative mjedisore dhe te masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimi cilesor me pika te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne mjedis te projektit.

Objektivat e VNM

Objektivat e hartimit te VNM- se konsistojne ne evidentimin dhe reduktimin e ndikimeve ne mjedis dhe masat tekniko-organizative per nje zhvillim te qendrueshem te mjedisit, gjate kryerjes se aktivitetit minerar deri ne perfundim te aktivitetit dhe rehabilitimin e hapesires se shfrytezuar dhe te prekur nga aktiviteti, per nje mjedis te qendrueshem ne vitet pas ardhese.

Me kete studim informojme organet vendim-marres, mbi ndikimet ne mjedis dhe perfitimet e projektit te propozuar. Gjithashtu zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe zbatimi i projektit nuk prek burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose veprimtari.

**b) Pershkrim i permbledhur i kuadrit ligjor
mjedisor dhe institucional qe lidhet me projektin**

-VKM nr.686 date 29.7.2015 « Per miratimin e rregullave , te pergjegjesive e te afateve per

zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e Deklarates Mjedisore »

- Ligj nr 12/2015 per disa ndryshime ne ligjin nr. 10440 date 07.07.2011 « Per vleresimin e ndikimit ne mjedis »
- VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja.
- VKM. Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”
- Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”
- Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”
- Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »
- Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »
- Ligj Nr 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.
- Udhëzim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »
- Udhëzim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’
- Urdhri e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”
- Udhëzimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”
- Udhëzim Nr 3, datë 17.05.2006 “Për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga guroret”
- VKM. Nr 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.
- Ligji Nr 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligji Nr 9115, datë 27.02.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujrave të ndotur”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”
- Ligji Nr 8906, datë 06.02.2002 “Për zonat e mbrojtura”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”
- Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave

2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

a. Qellimi i projektit te propozuar

Qellimi i projektit te propozuar eshte shfrytezimi i gurit gelqerore me kariere me punime siperfaqesore per furnizimin e tregut me inerte ne menyre te jete ne gjendje qe te perkrah zhvillimin ekonomik te shoqerise dhe te permiresoje gjendjen ekzistuese te lendeve te para si dhe Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis per aktivitetin hapje, pergatitje dhe shfrytezim te gurit gelqerore , mineral i grupit ndertimore ne objektin fshati Herraj, Zall Herr Tirane.

Kjo zone eshte e preferuar per shfrytezimin e gurit gelqerore me kariere me punime siperfaqesore sepse ka te ngritur infrastrukturen rrugore ka lehtesira ne transport me kosto te ulet te prodhimit duke qen se shoqeria ka kerkuar zgjerimin e lejes minerare qe disponon per kete vendburim.

b. Planimetria e vendodhjes se projektit , ku te pasqyrohen ne harten topografike siperfaqja e tokesse kerkuar , kufijt e siperfaqes se kerkuar , te dhenat per perdorimin ekzistues te siperfaqes se tokes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo instalimit te pajisjeve.

Zona e miratuar per zgjerim, ndodhet në luginën e lumit të Zall Herrit në të majtë të rrugës që lidh Komunën e Zall Herrit me ujëmbledhësin e Bovillës ne nje distance nga kjo rruge rreth 200 ml ne vije ajrore dhe kjo siperfaqe vendoset ne Lindje te Lejes minerare te shfrytezimit nr. 1641 date 21.06.2013

Ne Lindje dhe Jug Lindje te zones qe kerkohet zgjerimi kalon lumi i Tiranes ne nje distance rreth 250 mlarg ne vije ajrore,kurse ne Jug Perendim ndodhet fshati Herraj ne nje distance rreth 300 m largne vije ajrore.

Rilevi te zonës që kërkohet është përgjithësisht kodrinor dhe vendoset poshtë rrëzimit të malit të Herrajt, përgjithësisht i çveshur dhe pa ndonjë bimësi të zhvilluar, largë objekteve të banimit dhe rrugës auto. Brenda zonës nuk ka objekte banimi, apo të rëndësishme të veçant.

Zona qe ne kerkojme te zgjerojme ka keto kordinata shteterore :

Tabela nr.1 Tabela me kordinatat e zgjerimit

<i>Nr.i pikave</i>	<i>Y</i>	<i>X</i>
<i>1</i>	<i>45 89 162</i>	<i>44 04 395</i>
<i>2</i>	<i>45 89 281</i>	<i>44 04 293</i>
<i>3</i>	<i>45 89 424</i>	<i>44 04 458</i>
<i>4</i>	<i>45 89 310</i>	<i>44 04 535</i>
<i>5</i>	<i>45 89 212</i>	<i>44 04 472</i>

Siperfaqjae zgjerimit qe kerkohet eshte 0.033 km2

Permbledhje Joteknike e VNM

Shoqeria IN CO shpk

Tabelanr. 2.Tabela , me koordinatat e zones se lejes minerare ekzistuese nr. 1641 date21.06.2013

<i>Nr.i pikave</i>	<i>Y</i>	<i>X</i>
1	44 04 292	45 89 070
2	44 04 152	45 89 326
3	44 04 170	45 89 426
4	44 04 405	45 89 151
5	44 04 325	45 89 110

Siperfaqja e lejes ekzistuese nr. 1641 $S = 0.033 \text{ km}^2$

Me kerkesen e subjektit "IN CO", sh.p.k, lidhur me zgjerimin e lejes minerare te shfrytezimit Nr. nr. 1641 date21.06.2013 te gelqerorit ne objektin Herraj, rrethi Tirane, rezultoi se kerkesa e bere nga subjekti ploteson kriteret e percaktuara ne nenin 9, pika1 dhe 57, pika 2/1, te Ligjit Nr. 10 304, " Per sektorin minerar ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar, si dhe kriteret e percaktuara nga **VKM, Nr.218, datë 11.03.2015**, "Per percaktimin e kriterëve, procedurave dhe rregullave per shfrytezim, ne siperfaqe dhe nentoke, te zonave qe jane ngjitur me zonat ekzistuese dhe ndryshimin e koordinatave per lejet minerare te percaktuara ne hapesire me tri koordinata".. Objekti ben pjese planshetin e shkalles; Sh 1: 25 000 me nomenklatue **K-34-88-D-a (Kurcaji)** dhe kufizohet nga pikat me koordinatat si ne tabelen e mepostme:

Tabelanr. 3.Tabela me koordinatat e zgjerimit dhe te lejes ekzistuese(**Si behet kjo leje**)

<i>Nr.i pikave</i>	<i>Y</i>	<i>X</i>
1	44 70 200	44 98 720
2	44 70 336	44 98 835
3	44 70 090	44 98 979
4	44 70 100	44 98 997
5	44 70 354	44 98 963
6	44 70 425	44 98 910
7	44 70 450	44 98 815
8	44 70 290	44 98 655

Siperfaqja e zonës për shfrytëzim është ; $S = 0.0663 \text{ km}^2$ ose 6.63 hektare

HARTA TOPOGRAFIKE ME KUFIRIN DHE KOORDINATAT E ZGJERIMIT TE LEJES MINERARE Nr.1641/1 Shkalla 1 : 25 000



Shoqeria "IN CO" sh.p.k.

Shfrytezim Gelqerore
Objekti Herra, TIRANE
Leja Minerare Nr.1641/1
Siperfaqja = 0.0663 km²



KOORDINATAT KUFIZUESE

Nr. pikes	X	Y
1	45 89 070	44 04 292
2	45 89 326	44 04 152
3	45 89 426	44 04 170
4	45 89 281.5	44 04 293.5
5	45 89 424	44 04 458
6	45 89 310	44 04 535
7	45 89 212	44 04 472
8	45 89 162.3	44 04 395.4
9	45 89 151	44 04 405
10	45 89 110	44 04 325

Permbledhje Joteknike e VNM
Shoqeria IN CO shpk



Foto Nr. 1 dhe 2 Pamje nga zona ku kerkohet te behet zgjerimi i lejes



c. Informacion per qendrat e banuara, ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendodhja e projektit te propozuar, si dhe percaktimin e njesise se qeverisjes vendore qe administron territorin ku propozohet projekti

Zona ku do te shfrytezohet per nxjerrjen e gurit gelqerore ndodhet ne fshatin Herraj , Njesia Administrative Zall Herr , Qarku Tirane.

Nga pikpamja gjeografike terreni ku shtrihet objekti per shfrytezim, duke qene se ben pjese ne zonen kodrinore malore qendrore se vendit tone, eshte terren kodrinoro malor , i nderthurur ndermjet pjeses fushore kodrinore dhe asaj malore , lartesia e te cilave eshte me e madhe se 500 m mbi nivelin e detit Ne Jug te objektit te objektit ndodhet fshati Priska e Vogel ne nje distance rreth 1 km larg ne vije ajrore, kurse ne Jug Perendim te zones qe kerkohet te behet zgjerimi ndodhet fshati Herraj ne nje distance ne vije ajrore rreth 400m fshati Herraj .

Ne jug te zones qe kerkohet leja Mjedisore kalon rruga auto Zall Herr – ujembledhesi i Bovilles ne nje distance rreth 220 m larg ne vije ajrore.

Poshte kesaj rruge kalon lumi i Tiranës ne nje distance nga zona qe kerkohet per zgjerim rreth 250 larg ne vije ajrore

Objekti shtrihet nga kuota me e poshteme prej +340 m deri ne ate te sipërme prej +495 m.

Vete objekti ben pjese ne zonen shkembore gelqerore qe quhet shpati i Herrajit dhe shtrihet ne Veri Lindje te ketij fshati. Vete terreni kuzhvillon aktivitetin leja minerare eshte pak i aksidentuar dhe i shpelare nga erozioni dhe bimesi te ulet, shkure, barishte, etj.

Popullsia e kesaj zone i perket nje zone rurale dhe merret kryesisht me pune bujqesore, blegtorale dhe nje pjese e vogel eshte e punesuar ne objekte te ndryshme minerare qe jane ne aktivitet ne kete zone. Ata banojne ne fshatrat per rreth si; Zall herr, Herraj, Priske e Vogel,.. etj dhe bejne pjese ne njesite administrative Zall Herr , si pjese perberse te Bashkise Tirane.

Nje pjese e mire e popullsisë punon ne emigracion

Aktualisht sipërfaqja qe do te shfrytezohet perdoret nga banoret e zones per kullote

Kulturat kryesore qe kultivohen në këtë rajon janë gruri, patatja, misri, lule dielli, jonxha etj. Vlen të theksohet se rendimentet, që merren nga toka janë mjaft të larta. Gjithë toka është mjaft e sistemuar dhe e ndërprere nga një rrjet i dendur kanalesh vaditëse kulluese.

ç. Skicat dhe planimetrite e objekteve te projektit dhe strukturave te projektit

Ky projekt nuk kerkon ndertim te strukturave me themele. Objekte ne sherbim te aktivitetit jane:

-Objekti i sherbimit si zyrtar, te sherbimit te punonjesve se banje, garderobe, dhome te ndihmes se shpejte, ky objekt do te jete kontoniere me sanduic te mobiluar, te cilet do te vendosen ne bazamente te ngritura nga toke trare me lartesi mbi 40cm.

d. Pershkrim i procesit ndertimore dhe teknologjike, perfshire kapacitetet prodhuese perpunuese , sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit

Varjantet e hapjes me punime te reja

Mbeshtetur ne pozicionin e vendburimit, relievin e tij, infrastrukturen dhe permasat e siperfaqes se kerkuar per shfrytezim dhe prania e punimeve te vjetra do te kryhet hapja vetem brenda konturit te projektuar dhe lidhja me rrugen automobilistike Zall Herr – Ujembledhesi i Bovillese shte i bere pasi zgjerimi eshte bere per lejen minerare te shfrytezimit nr. 1641 date 21.06.2015 dhe infrastruktura eshte e gateshme pasi eshte punuar ne kete leje pra nuk ka nevojte per hapje rruge te re per te shkuar ne objekt por do te kete hapje rruge vetem brenda zgjerimit Per te arritur ne piken me te larte te zgjerimit eshte planifikuar te hapet nje rruge me gjatesi rreth 1800ml dhe pkerisht nga pika A,kuota +295m dhe do te perfundoje ne kuoten + 460m pika 19. Ne krahun e djathte te saj do te hapet kanali per kullimin e ujerave.

Gjeresia e kesaj rruge(Transhe hapese me seksion gjysem trapezoidal te permbysur)eshte 4-6 m. Pjerrësia mesatare e rruges do te jete 8%. Kjo rruge do te mbrije ne afersi te konturin 5, ne kuoten +460 m. Hapja e kesaj rruge eshte kryer duke germuar direkt ne seksionin e saj me focen mekanike te koves se ekskavatorit. Ajo eshte shtruar me material te trashe nga mbeturina te gelqeroreve qe jane gjendje ne pjesen e shfrytezuar te lejes se vjeter te kesaj karriere. Pjesa e siperme e rruges eshte shtruar me çakull te imet duke kryer ngjeshjen me rul. Në krahun e djathte te saj do te hapet kanali per kullimin e ujerave. Ne pjese te veçanta ku kalojne perrenje te vegjel dhe proska do te ndertohen vepra arti dhe do te vendosen tombina. Nga rruga lidhese qe do te sherbeje si transheja kryesore e hapjes e cila do te kete dy degezime qe do te sherbejne si transhe kryesore te hapjes do te hapen transhet lidhese te shkalleve te karrieres nga lart poshte:

Punimete kryesore te hapjes se ketij objekti do te jene:

Transheja kryesore e hapjes +460 m me kuoten +460 me cila do te hap me radhe horizontet +450, +440+430 +420, +400, +390 dhe +380, i cili do te jete horizonti me i i ulet i sheshit te pare te shfrytezimit. Gjatesia e transhese Nr.1 do te jete: $L_1 = 150$ m. Kjo transhe eshte hapur me gjeresi 4-6 m dhe pjerrësi; $i = (8-10) \%$. Seksioni i transhese kryesore te hapjes do te jetegjysem trapezoidale.

Transheja e perbashket e hapjes do te filloje ne kuote +380 m dhe do te vazhdoje duke u ngjitur deri sa te arrije ne fillim ne kuoten +460 m per te hapur kete horizont. Me pas kjo transhe do te vazhdoje edhe me tej ne drejtim te kuotes +460 dhe kur arrin ne ate kuote do te sherbeje per te hapur kete horizont. Kjo transhe do te perfundoje ne kuoten +380 m. Kjo do te jete edhe kuota e fundit ku do te vendosen makinerite e renda germuese dhe transportuese. Ne çdo horizont do te hapen transhet e prerjes me gjeresi 4-5 m pjerrësi horizontale dhe seksion trekendesh.

Radha e hapjes se ketyre transheve do te jete nga larte poshte.

Radha e hapjes se ketyre shkalleve do te jete nga larte poshte. Hapja e transhese se perbashket do te kryhet nga larte poshte. Me mbritjen e trashese se perbashket ne horizontet baze +380 do te hapen transhete e prejes te cilat do te kene pjerrësi horizontale duke ndjekur izoipsin ne horizontin perkates. Gjeresia e tyre do te jete 4-6 m, gjatesia; $L_2 = 170$ m dhe pjerrësia; $i = 8-10 \%$.

Tabela me elementet e karrieres.

Nr.	Emërtimi i elementeve të karrierës	Njësia matëse	Vlera
1	Thellessia e karrieres	m	130
2	Gjeresia e zones se kerkuar	m	90-300
3	Gjatesia e zones se kerkuar	m	200
4	Lartesia e shkalles	m	10
5	Numri i shkalleve	m	13
6	Kendi i shuarjes se shkalleve	Grade	44
7	Kendi i pjerresise se shkalles se punes	Grade	70
8	Gjeresia e karrieres larte	m	300
9	Gjeresia e karrieres poshte	m	90
10	Gjatesia e karrieres larte	m	260
11	Gjatesia e karrieres poshte	m	300
12	Kuota me e larte e shfrytezimit	m	+460
13	Kuota me e ulet e shfrytezimit	m	+340

Me poshte po paraqesim planimetrine e karrieres ne fazen perfundimtare ne shkallen 1: 1000

e. Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrike, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve si dhe informacion per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojen per hapje te rrugeve te reja

Energjia per ndricim eshte marre nga linja e fshatit qe kalon ne afersi te objektit, per kete subjekti ne bashkepunim me OSHEE te rrethit Tirane do te beje ngritjen e nje linje te re jashte kontureve te lejes minerare.

Furnizimi me uje i objektit te karrieres eshte realizuar me anen e depozites me uje, te cilin subjekti tashme e ka gjendje nga leja ekzistuese.

Shkarkimet e ujerave

Ne procese teknologjike te shfrytezimit te gurit gelqerore me kariere nuk do te perdoret uji. Aktiviteti do te prodhoje guri gelqeror per prodhim inertesh. Ne dite me rreshje ne kariere nuk punohet nje nder arsyt eshte se guri gelqeror me prezence uji e varferon ate. Uji do perdoret per lagien e territorit per paksimin e pluhurave gjate procesit te nxjerrjes se gurit gelqeror dhe do sigurohet permes depozitave nga shoqeria.

Ujerat e shiut do te sitemohen permes kanaleve perimetrike dhe do i bashkohen prroskave te zones me rrjedhje natyrale.

Rrugët ekzistuese të aksesit apo nevoja për hapje të rrugëve të reja

Punimet lidhëse me rrugën auto Zall Herr Ujëbledhësi i Bovillës janë kryer. Për të arritur në këtë objekt ekziston një rrugë e cila kalon në pjesën e poshtme të karrierës në pjesën lindore të saj, që ndodhet në krahun e majtë të rrugës auto.. Kjo rrugë është e asfaltuar, dhe nga kjo rrugë është rruga e hapur që shkon në karrierën ekzistuese, pra nuk do të kemi probleme në infrastrukturë pasi është e ndërtuar. Në pjesë të veçanta do të kalojnë prerrenjë të vegjël dhe peroska do të ndërtohen vepra arti dhe do të vendosen tombina.

f. Programi për ndërtimin, kohezgjatjen e ndërtimit, kohezgjatja e planifikuar e funksionimit të projektit, kohën e mundshme të perfundimit të funksionimit të projektit dhe faza e planifikuar për reabilitimin e sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit.

Punimet e ndërtimit për venien në shfrytëzim të karrierës janë:

- Ndërtimi brenda territorit të karrierës të rrugëve lidhëse
- Ndërtimi i linjës së furnizimit me energji elektrike të objektit

Punimet kryesore të hapjes.

Përshkrimi i punimeve kryesore të hapjes.

Punimet kryesore të hapjes në këtë vendburim do të jenë, rruga lidhëse e cila do të shërbejë për lidhjen e këtij objekti me kuotën me të lartë të objektit e cila do të jetë vetëm brenda sipërfaqes së miratuar. Kjo rrugë do të jetë e afërsisht rreth 650m m. Nga kjo rrugë do të hapet një degezim i cili do të mbërrijë në kuotën +495 m. Kjo rrugë do të jetë e gjatë 650m dhe do të jetë me pjerresë: $i = 8 - 10 \%$ dhe gjerësi (4-6) m. Nga rruga rurale do të hapen dy transhe transheja Nr.1 dhe transheja Nr.2

Përcaktimi i sheshit të depozitimit të sterilizimit. Llogaritja e kapacitetit depozitues

Sasia e sterilizimit, që do të dalë nga shfrytëzimi, parashikohet të jetë jo e madhe krahasuar me prodhimin. Kjo për dy arsye:

- Mbulesa mbi gelqeroret është e vogël që shkon rreth 10-15cm dhe tek tuku në 0.5m në disa pjesë të vogla kurse pjesa tjetër e e zbuluar totalisht, ku nga llogaritjet e bëra rezulton të jetë rreth 3000m³ sterile për të gjithë pjesën që zgjerohet - Materiali që do të prodhohet gjatë shfrytëzimit dhe hapjes së rrugëve të brendshme, do të spostohet në sheshet provizore të sterilizimit dhe mandej në hapësirën e shfrytëzimit.

Sterilizimi parashikohet pjesë e sipërme mbi pakove të gelqeroreve dhe ajo që është midis blloqeve të gelqeroreve si nderfutje.

Mbeshtetur sa më sipër, sheshi për depozitimin e sterilizimit është planifikuar në fund të konturit të lejes në një sipërfaqe prej **6500m²**

Projekti mbylljes dhe i rehabilitimit te karieres dhe fazat e zhvillimit.

Mirembajtja e shesheve te shkalleve dhe hapja e rrugeve automobilistike dytesore midis shesheve te shkalleve

Me perfundimin e shfrytezimit te shkalles se pare dhe fundore ne çdo horizont do te lihet sheshi i sigurimit me gjeresi 4m. Me projekt eshte parashikuar qe keto sheshe te lidhen me rruge automobilistike e cila do te sherbeje per te levizur lirshem punonjesit e komunitetit, kafshet shtepiake, kafshet e egra dhe per te kryer te gjitha punimet e nevojshme te rehabilitimit te zones se shfrytezuar mbjelljen e pemeve dhe gjelberimin e saj, si dhe mbushja me dhera humusore transporte te fidanave etj.

Ndertimi kunetave ne pjesen e siperme te skarpates se shkalleve

Meqenese zona ku kryhet aktiviteti perbehet nga depozitime gure gelqerori te cilat ne periudha me rreshje humbin qendrushmerine, me projekt ne pjesen e siperme te skarpateve te shkalles se pare te shfrytezimit do te ndertohet kunete ne gjith gjatesine e skarpates. Ujerat e grumbulluar ne kunet do te mbroje skarpaten e shkalles dhe do ta percjelle ujin deri tek kolektori i grumbullimit te ujerave atmosferike.

Hapja e kanaleve per dranazhim

Ne fundin e skarpates se çdo sheshi shkalle do te hapen kanale me permasa 60 cmx50cm x 20cm dhe pjerresi 5 % nga te dy krahet e sheshit per kullimin e ujerave dhe rreshjeve atmosferike te cilat do te drenohen poshte kontureve te karieres, fenomen qe shmang grumbullimin e ujit ne sheshin e shkalles, mbron nga erozioni sheshin e sigurimit dhe te gjith karrieren. Gjithashtu pjerresia e sheshit te siguris se shkalles duhet ti jepet pjerresi ne drejtim te kanalit

Mbulimi me dhera humusore i siperfaqeve te shesheve te shkalleve

Duke qene se sheshet e shkalleve jane ne depozitime gure gelqerori ku bimesia nuk zhvillohet, per te krijuar kushte optimale per druret dhe bimesine qe do te mbillet e gjith siperfaqja e shesheve te shkalleve do te mbushet me nje trashesi dheu vegjetal (Humusor) prej 0.3 m.

-Masat rehabilituese

Punimet qe do te kryen per rehabilitimin e zones se shfrytezuar

-Punime inxhinierike

-Punime biologjike

-Punime inxhinierike

-Hapja dhe mirembajtja e rrugeve automobilistike per hyrje ne sheshin e sigurise se shkalleve

-Hapja e kunetave dhe kanaleve per drenazhim dhe disiplinimin e ujerave te rreshjet atmosferike

-Punime biologjike

-Mbushja me dhera humusore me trashesi 30cm te shesheve te shkalleve dhe pergatitja e tokes per mbjellje me bimesi.

-Mbjellja e bimesise qe rritet ne zone

-Sherbimet profilaktike ne siperfaqet e rehabilituara.

g. menyrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve te projektit

1-Ndertimi i trasese se rruges ne teritorin e karieres do te behet me metoden e coptimit te gurit gelqerore me matrapik te montuar ne krahun e eskavatorit.

Trasea e rruges si kemi treguar dhe me siper do te ndertohtet ne teritorin e lejes minerare.

Punimi do te hapet nga rruga ekzistuese qe kalon ne gjith gjatesine e karieres

2-Objekti i sherbimit me konstruksion sanduici do te perdoren ekzistuesit

3-Furnizimi me energji elektrike i objektit do te behet nga linja qe furnizon fshatin. Menyra e furnizimit te kabines nga linja elektrike tre fazore mund te behet me linje kabllore ose linje ajrore. Varianti me i mire do te percaktohet nga specialistet e OSHEE.

h. lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje dhe energji)

Per ndertimin e rruges se hapjes se karieres,

ndertimin e linjes elektrike dhe shfrytezimit te gurit gelqerore ne kariere do te perdoren makinerit, si: eskavator me zinxhira, kamione transporti me motora dizel qe punojne me karburant (Dizel).

Karburanti do te furnizohet nga subjekte te licencuara per import, ruajtje dhe tregtim te karburanteve ne republiken e Shqiperise. Ndersa per mbrojtjen nga pluhuri, per nevoja vetiake dhe nga punonjesit, mbrojtjen nga zjarri dhe sherbime te tjera do te perdoret uje. Uje do te sigurohet me rezervuar qe do te furnizohet me autobot.

Lendet e para ndihmese qe do te perdoren ne kariere jane:

- Naftë dhe Vajra lubrifikant

-Uje do te sigurohet me depozite nga shoqeria

-Energjia elektrike per ndricim ne karieren do te sigurohet nga linja e fshatit ne baze te kontrates qe do te lidhet

J. informacion lidhur me alternativat e marra ne konsiderate

persa i takon perzgjedhjes se vendodhjes se projektit dhe teknologjise qe do perdoret

Ne baze te lejes minerare nr. 1641 date 21.06.2013 shoqeria IN CO shpk shfrytezon objektin Herraj njesia administrative Zall Herr rrethi Tirane, dhe ka kerkuar te bej zgjerimin e kesaj leje minerare duke pare se ka rezerva te konsiderueshme te minelarit per shfrytezim. Aktiviteti i cili kerkon te zhvillohet eshte ne vazhdimesi te aktivitetit te shfrytezimit qe shoqeria ka zhvilluar. Nje pjese e rrugeve dhe objekteve te sherbimit te karieres ekzistuese do te sherbejn edhe per karieren e re.

.Tabela me koordinatat e zgjerimit dhe te lejes ekzistuese(Si behet kjo leje)

<i>Nr.i pikave</i>	<i>Y</i>	<i>X</i>
<i>1</i>	<i>44 70 200</i>	<i>44 98 720</i>
<i>2</i>	<i>44 70 336</i>	<i>44 98 835</i>
<i>3</i>	<i>44 70 090</i>	<i>44 98 979</i>
<i>4</i>	<i>44 70 100</i>	<i>44 98 997</i>
<i>5</i>	<i>44 70 354</i>	<i>44 98 963</i>
<i>6</i>	<i>44 70 425</i>	<i>44 98 910</i>
<i>7</i>	<i>44 70 450</i>	<i>44 98 815</i>
<i>8</i>	<i>44 70 290</i>	<i>44 98 655</i>

Sipërfaqja e zonës për shfrytëzim është ; S = 0.0663 km² ose 6.63 hektare

***k. Perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit, perfshire
sasite e ujit te nevojshme , energjise, lendeve djegese dhe menyren e sigurimit te tyre***

Ky aktivitet eshte aktivitet shfrytezimi i cili konsiston ne nxjerrjen e gurit gelqeror pra do te perdor lende te para por siguron lende te pare per industrine e ndertimit. Guri gelqerore qe do te dali ne kete zone qe zgjerohet do te sherbej per prodhim inertesh. Uji perdoret vetem ne rastet per lagien e territorit ne menyre qe te mos kete krijim te pluhurave gjate veprimtarise sidomos ne kohe te thate dhe me ere, kjo sasi uji sigurohet permes depozitave te ujit qe shoqeria siguron per kete qellim. Lendet djegese qe perdorin mjetet e transportit sigurohet ne pikat e furnizimit me karburant.

Lendet e para ndihmese te konsumuara per prodhim gure gelqerorei te projektuar 75m3/dite jane:

- Nafta 1.2 litra/m³
- Vajrat lubrifikante 0.065 litra/m³
- Uje 50m3 per te lagur nje siperfaqe 5000m²
- Energjia elektrike per ndricim ne karieren = 5kw

l. Aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin

e projektit , si ndertim i kampeve apo rezidencave etj.

Zhvillimi i projektit nuk kerkon ndertimin e kampeve per qendrimin e punetoreve gjate kohes se shfrytezimit sepse numri i te punesuarve nuk eshte aq i madh sa per te ndertuar keto kampe per fjetje apo mensa sherbimi dhe gjithashtu te punesuarit jane nga zona perreth vendburimit qe do te shfrytezohet dhe punojne vetem me nje nderese ne dite.

Vepra inxhinierike qe do te ndertohen ose zgjerohen per shfrytezimin e gurit gelqerore nuk do te kete. Teknologjia e shfrytezimit te gurit gelqerore eshte e thjeshte konsiston ne nxjerrjen e blloqeve te tyre, ngarkimin dhe transportin drejt destinacionit te kerkuar. Shfrytezimi do te behet ne siperfaqe me kariere.

m. Informacion per lejet dhe licensat e nevojshme per projektin te kerkuara

nga legjislacioni ne fuqi si dhe institucionet kompetente per lejimin/licensimin e projektit

Pasi eshte miratuar nga MEI kerkesa per zgjerim te lejes minerare nr. 1641 date 21.06.2013 duhet te pergatise dokumentat per pajisjen me Leje Minerare per shfrytezimin e gurit gelqerore dhe shqyrtimin e dosjes nga AKBN-ja. Pjese e procedures per marrjen e lejes minerare eshte edhe pajisja me Deklarate Mjedisore si dhe Leje Mjedisore e Tipit B nga Ministria e Mjedisit.

3. NJE PERSHKRIM I ANALIZES TE PAKTEN E DY ALTERNATIVAVE PER ZBATIMIN E PROJEKTIT

Theksojme per organet vendim marrese, se mundesia e alternativave te marra ne konsiderat per perzgjedhjen e vendodhjes se projektit nga subjektet minerare ne teresi jane ne nivelin zero per keto arsye:

- Zona minerare dhe objekti percaktohet nga MEI me propozim te AKBN dhe shpallet ne planin tre vjecar dhe nji vjecar te Ministrise.
- Investitoret qe kryejne aktivitetet minerare jane para nje fakti te kryer per pjesmarrje ne tender te zonave minerarte te shpallura per konkurim.

Duke qen se shoqeria ka shfrytezuar kete vendburim ne baze te Lejes Minerare qe ka disponuar me nr. 1641 date 21.06.2013, ka kerkuar zgjerimin e kesaj leje minerare duke pare se rezervat per shfrytezim jane te konsiderueshme. Subjekti privat "IN CO"sh.p.k ka marre nga Ministria e Energjise dhe Industrise "*Njoftimin per fillim procedurash per zgjerimin e lejes minerare te shfrytezimit nr.1641,date 21.06.2013*" me nr, 36 47 Prot. date 04.07.2016 dhe ka fituara te drejten e pergatitjes se dokumentacionit per aplikim per leje Mjedisore per minerale te grupit te materialeve te ndertimit gure gelqerore per prodhim inertesh.

Projekti hapjes se karieres ka per qellim lidhjen e fronteve te prodhimit te gurit gelqerore (te shesheve te shkalleve) me rrugen nacionale te transportit.

Hapja e vendburimit do te behet nga rruga ekzistuese e fshatit Herraj. Hapja e vendburimit eshte projektuar ne menyre qe shfrytezimi i gurit gelqeror ne kariere te behet nga lart poshte.

Teknologjia qe do perdoret per shfrytezimin e gurit gelqerore eshte e thjeshte.

Ngarkimi prodhimit ne sheshin e shkalleve te shfrytezimit do te behet me eskavato me zinxhira, me kapacitet kove 2m3

Transporti prodhimit deri ne destinacion do te behet me atomjete vetshkarkuese 16m3.

4. NJE PERSHKRIM TE GJENDJES DHE VLERAVE EKZISTUESE TE MJEDISIT QE MUND TE NDIKOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

4.1 Pershkrim te karakteristikave fizike te zones se projektit

Objekti i gelqeroreve Herraj, rrethi Tirane ndodhet ne pjesen veriore te rruges qe shkon nga fshati Zall Herr ne ujembledhesin e Bovilles ne afersi te fshatit Herraj dhe lidhet me kete rruge me nje degezim rreth 0.8 km, objekti lidhet gjithashtu dhe me fshatin Herraj me rruge te dyta te hapura gjate ushtrimit te aktivitetit minerar apo nga rruga rurale qe kalon aty prane. Kufizohet ne nje pjese te shpatit shkembor gelqeror qe perfaqeson pjesen e poshteme te vendburimit te gelqeroreve. Administrativisht i perket ndarjes administrative, Bashkise se Tiranes, njesia administrative Zall Herr dhe eshte nen juridiksionin e njesise administrative Zall Herr (Bashkia Tirane).

- pershkrim i faktoreve klimatike

Klima e zones karakterizohet nga nje vere e thate dhe me dimer te ftohte me reshje shiu dhe bore. Era fryn kryesisht nga drejtimi i veriut. Duke qene se zona karakterizohet nga nje ndryshim i madh kuote per shkak te ndryshimit te temperatures se ajrit ne vere rryma e ajrit leviz nga zonat e uleta ne zonat malore dhe ne dimer ne te kunderten.

Temperatura ne periudhen e dimrit me ngrica te medha (Janar - Shkurt) arrin ne -5°C , ndersa ne stinen e veres (Korrik – Gusht) temperatura luhetet 27- 40 $^{\circ}\text{C}$. Ne kete territor bien reshje mesatare te shiut deri 1300mm, kryesisht ne fundin e Vjeshtes dhe ne Pranvere.

Reshjet e Veres bien ne forme rrebeshi.

Numri i diteve me reshje lekundet nga 95 - 100 dite.

Ne stinet pranverore dhe te vjeshtes zona pershkohet nga erëra te ngrohta, hera- heres murlani te cilat kryesisht vijne nga prendimi, por edhe nga VL qe sjellin prishjen e motit dhe shkarkim reshjesh.

Ne Vere keto erera jane te nxehta dhe te thata qe shkaktojne temperatura te larta deri ne zagushi.

Ne periudhen e Dimri erërat vijne nga veriu, , qe jane erera te ftohta shoqeruar me ulje temperature e rreshje te dendura debore.

- pershkrim i gjeologjise dhe tokes ne zonen e projektit

Formacionet qe marin pjese ne ndertimi gjeologjik te rajonit

Nga ana tektonike rajoni i studimit ben pjese ne zonen qendrore, masivi karbonatik Kruje Dajt dhe perfaqeson krahun monoklinal perendimor te sinklinalit te ka qene objekt studimesh e vrojtimesh nga specialiste gjeologe vendas dhe te huaj. Kete rajon e ka rilevuar ne shkallen 1:50000 dhe 1:25000 Th.Petro, A.Xhomo, P.Pashko (1973-1974); vrojtme e rlevime te shkalleve te medha kane kryer ne rajonin Kruje Dajt edhe S.Hoti (1976); L.Hoxha, P.Kalina, A.Palko si dhe K.Onuzi .Ne pjesen Perendimore te rajonit kemi nje suate qe ofron prerje tipike

te kompleksit karbonatik. Ky kompleks perbehet nga: Kompleksi i shkembinjve plutogjene dhe kompleksi i shkembinjve vullkanogjene.

Formimet me te reja qe ndeshen ne rajon jane ato te Kuaternarit te perfaqesuara nga suargjila e suranore si dhe deluvionet ndeshen ne pjesen Lindore-Juglindore te rajonit pikerisht ne pjesen e fushes se Korces.

KRETAKU (Cr)

Depozitimet kretake jane mjaft te perhapura ne zonen ne fjale. Ato ndeshen ne trajte sinklinalesh dhe monoklinalesh te vendosur ne pergjithesi me mospajtim mbi ofiolitet dhe mbulesen e tyre. Me rralle ato vendosen dhe mbi karbonatet e buzeve kontinentale (Peza L.H., etj. 1981, 1985, Kodra, Gjata 1982, Shehu R., etj. 1990, Marku D.). Si rrjedhoje e relievit para kretak shume te aksidentuar verehen dhe diferenca te theksuara qofte persa i perket kohes se mbulimit te sektoreve te ndryshem nga keto depozitime qofte dhe persa i perket perberjes faciale te tyre. Nga punimet stratigrafike ne disa prerje jane detajuar grup kate dhe kate, por mbasi shkalla e detalizimit nuk eshte e njejte ne shtrirjen e ketyre depozitimeve, ne zonen e Mirdites do te vecohen depozitimet e Kretakut te poshtem, Kretakut te siperm e ne disa sektore, ne Mirditen jugore dhe ato senoniane, te vendosura me pushim mbi gelqeroret e Kretakut te poshtem ose me transgresion mbi ofiolitet dhe gelqeroret e Triasikut te siperm.

Kretaku i siperm (Cr2)

Depozitimet e Kretakut te siperm ne zonen e Mirdites jane te perhapura ne Zall Herr-Herraj. Ne prerjet veriore zakonisht depozitimet e Kretakut te siperm jane vazhdim i serise karbonatike te Kretakut te poshtem. Prerje te tilla te vijueshme te depozitimeve kretake takohen dhe ne Mirditen jugore ne rajonin e Zall Herr dhe Herrajit. Depozitimet e Kretakut te siperm perfaqesohen nga gelqerore biomikritike dhe turbiditike shtresemesem deri masive dhe i perkasin facies neritike. Ne ndonje rast ne kreun e prerjes se tyre takohen dhe gelqerore pllakore me globotrunkana.

- *Pershkrim i ujerave siperfaqesore dhe nentokesore ne zonen e projektit*

Per nga pikpamja hidrologjike dhe hidrografike objekti i kerkuar ndodhet ne kushte te mira. Nuk ka burime natyrale ujerash. Eksperienca 6 vjeçare e shfrytezimit te tij ka treguar se ne zone nuk jane takuar ujëra nentokesore dhe burime te perhereshme me perjashtim te rreshjeve te ndryshme atmosferike. Sic u permend me siper vendburimi perfaqeson nje strukture monoklinale ne formen e nje kodre plotesisht te drenuar dhe nuk ka permbajtje ujerash ne te, me perjashtim te ndonje sasie e vogel ne kuotat e poshteme te cilat jane ne kuoten e sheshit ku parashikohet te ndertohet impianti i thyejes dhe klasifikimit. Duke gjykuar nga topografia e terrenit, ndertimi gjeologjik i rajonit, topografia e zones se objektit dhe te dhenat hidrogjeologjike te mara nga punime te tjera te kryera ne teren per qellime te ndryshme, mund te themi se kushtet hidrogjeologjike jane te thjeshta. Dallohen kryesisht ujra debiti i te cilave varet nga reshjet atmosferike dhe nuk perben ndonje problem te rendesishem per shfrytezimin e objektit.

Nga pikpamja hidrogafike, objekti nuk kufizohet me perrenj apo proska te vogla dhe drejtimi pergjithshem i rrjedhes se ujrave eshte ne drejtim te Jug-Lindjes, drejt rruges auto te permendur me siper , ku eshte parashikuar te ndertohet nje kanal, qe do te sherbeje per kullimin e tyre Prania e ujrave te rreshjeve nuk veshtireson kushtet teknike te shfrytezimit te objektit pasi ato mund te rrjedhin ne drejtimimin e permendur me siper. Mineralizimi i ujrave do te jete i tipit Hidro-karbonat magnezial i perdorshem per t'u pire , me vlere maksimale te pH = (5.8-7.2).

Pershkrim i biodiversitetit ne zonen e projektit

Problemet e biodiversitetit perbejne aktualisht nder problemet me me rendesi ne rruzullin tokesor. Termi biodiversitet eshte shume kompleks dhe si i tille, zhvillimi dhe percaktimi i strategjive te pershtatshme per mbrojtjen e tij, shoqerohet me nje proces te veshtire zgjedhjesh dhe vendimmarrjesh. Biodiversiteti perben teresine e llojeve dhe ekosistemeve ne nje rajon, apo ne gjithe rruzullin tokesor. Ekosistemet jane te nje rendesie te vecante sepse ato perbejn bazat per ekzistencen e llojeve. Cenimi i tyre, si rezultat i aktiviteteve te ndryshme ekonomike shoqerore perben nje shqetesim per njerezit dhe studiuesit . Vlera e nje biodiversiteti te larte per njerezimin jepet para se gjithash nepermjet funksionit te tij si stabilizator i biosferes dhe si burim direkt i prodhimit.

- Pershkrim i habitateve kryesore ne zonen e projektit si dhe harta ilustruese

Per nga origjina , perberja dhe vecorite gjeobotanike bimesia e Shqiperise ben pjese ne nenzonen floristike mesdhetare e cila perfshihet ne nje njesi me te madhe, ne zonen holarktike. Ndikim te madh ne zhvillimin e flores mesdhetare ushtroi ftohja e pergjithshme e klimes ne periudhen e pleistocenit dhe akullzimi i fuqishem qe pasoi ate. Tiparet karakteristike te bimesise mesdhetare si per sa i perket vecorive gjeobotanike ashtu edhe perberjes morfologjike dhe shtrirjes vertikale te saj, jane karakteristike edhe per bimesine e vendit tone. Por kushtet konkrete te zhvillimit, sidomos te klimes dhe te relievit kane percaktuar edhe vecorite origjinale te flores se Shqiperise. E gjithe kjo pasuri floristike i detyrohet vecorive te evolucionit paleogeografik te Shqiperise dhe sidomos larmise se madhe te klimes, copetimit te theksuar te relievit dhe formave te shumellojshme te tij, formacioneve te shumta shkembore (gelqerore, magmatike, terrigjene) etj. Fitocenozat e bimesise barishtore shume te larmishme nga perberja e llojeve, gjenden ne te gjitha zonat fitoklimatike te Shqiperise. Megjithese fitocenozat barishtore nga ana e fizionomise ne pergjithesi duken relativisht te peraferta, ato ndryshojne midis tyre nga perberja floristike ne varesi te faktoreve ekologjike. Me perjashtime te pakta, gati ne te gjitha fitocenozat dhe bashkeshoqerimet barishtore gjenden perfaqesues te familjes graminore (Graminaceae).

- Pershkrim i vegjetacionit ne secilin habitat dhe statusit te ruajtjes kombetar dhe nderkombetar te tyre

Zona, ku do te kryhet aktiviteti minerar, eshte nje zone ne afersi te se ciles shoqeria ka ushtruar aktivitetin e shfrytezimit te gurit gelqeror dhe kerkon te zgjeroj siperfaqen e shfrytezimit.

Shoqeria IN CO shpk

Kjo zone ka mbi siperfaqen e saj bar te rralle. Siperfaqja e objektit eshte pothuajse masiv shkembor dhe nuk ka pasur mundesi te zhvillohet bimesi. Siperfaqja e planifikuar per shfrytezim nuk eshte toke bujqesore apo kullote. Persa i perket flores ne zonen ku do shfrytezohet guri gelqeror si shihet edhe nga fotot e meposhtme ajo paraqitet ne disa vende e zhveshur , mbizoteron mbulesa bimore e familjes graminore dhe vende –vende rriten ferra dhe shkurre te tjera si bezge, driza te cilat nuk gezojne status te vecante ruajtje.

Ne pjesen e poshteme te objektit ne zonen e dherave dhe ne siperfaqet e kultivueshme (mbuleses qe nuk perfaqeson rezerva gjeologjike) rriten lule dhe barishte si dhe kultivohen bime te ndryshme bujqesore dhe foragjere.

- Pershkrim i faunes ne secilin habitat dhe statusit te ruajtjes kombetar dhe nderkombetar te tyre

Ne kete grup te madhe te faunes hyjne kafshet gjitare te tokes (mishngrenese dhe barnngrenese) , shpezet, zvarraniket, amfibet , insektet etj

Te gjitha kafshet tokesore te vendit tone jane pothuajse te njejta ose te ngjashme me ato te krejt mesdheut , por sidomos me ato te Mesdheut europian. Ky unitet faunistik lidhet me faktin qe gjithë Mesdheu formon nje njesi me vete faunistike ne kuadrin e zones Paleoarktike, e cila nga ana e vet ben pjese ne nje njesi me te madhe faunistike, ne treven Holarktike. Ne pergjithesi fauna e Mesdheut nuk dallon per forma te shumta endemike, por ajo permendet per numrin e madh te perfaqesuesve te disa llojeve te kiroptereve, butakeve, zvarranikeve, te disa insekteve etj. Fauna tokesore e vendit tone me gjithë demtimet eshte ende e pasur. Ajo ka perfaqesuesit e vet ne te gjitha krahinat e zonat gjeografike te vendit dhe ne te gjitha lartesite , ku formohen biocenoza te caktuara.

Fauna e shkurreve mesdhetare jeton poshte shkurreve qe vende –vende jane shume te dendura. Kjo mbulesa bimore e zbut deri diku vapen dhe thatesiren e veres.

Fauna qe rritet ne zone nuk gezon status te vecante te ruajtes kombetare dhe nderkombetare.

- Pershkrim i zonave te mbrojtura prane vendit ku propozohet te zbatohet projekti perfshi edhe monumentet natyrore te mbrojtura me ligj.

Lidhja e objektit me rruge ekzistuese dhe ushtrimi i aktivitetit te shfrytezimit nuk prek zonat turistike dhe zonat e mbrojtura, sepse ne objektin e projektuar dhe per rreth nuk ka zona te mbrojtura me status te vecante. Eshte per t'u theksuar se nuk ka asnje veper arti te ndertuar nga njeriu.

Pershkrim i cilesise se mjedisit dhe ndikimeve ekzistuese

- cilesia e ujerave ne zonen e studiuar per hartimin e raportit te thelluar te VNM-se

Per nga pikpamja hidrologjike dhe hidrografike objekti i kerkuar ndodhet ne kushte te mira. Nuk vihen re burime natyrale ujrash. Pikerisht ne vendin ku kerkohet te shfrytezohet nuk ka prroska. Kur ka reshje, neper te rrjedhin me rrembim ujra siperfaqesore per shkak dhe te pjerresise mjaft te madhe te terrenit.

- cilesia e ajrit ne zonen e studiuar per hartimin e raportit te thelluar te VNM-se

Persa i perket cilesise se ajrit ne zone ai konsiderohet me parametra te pranueshem duke qen se ndodhet larg zonave te banuara dhe nuk eshte i ndotur nga veprimtarite e industrise. Edhe zhvillimi i aktivitetit te shfrytezimit nuk do te shkaktoj ndotje te ajrit sepse nuk do te kete emetime te gazeve ndotes.

- niveli i zhurmave ne zonen e studiuar per hartimin e raportit te thelluar te VNM-se

Ne afersi te projektit nuk ka veprimtari te cilat te shkaktojne zhurma mbi nivele te lejuara.

- Administrimi i mbetjeve ne zonen ku propozohet projekti

Administrimi i mbetjeve urbane në vendin tonë është i decentralizuar. Në pjesën më të madhe të qyteteve shërbimet e mbledhjes dhe transportimit të mbetjeve kryhet nga kompani privatë të menaxhimit të mbetjeve, të cilat janë të kontraktuara nga bashkitë. Në shumicën e bashkive të vendit, tarifa për menaxhimin e mbetjeve përfshin grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve deri në venddepozitim. Zonat rurale ne vendin tone nuk janë të mbuluara akoma nga shërbimet e menaxhimit të mbetjeve. Pjesa me e madhe e mbetjeve të këtyre zonave depozitohen nëpër lumenj ose në anë të rrugëve të cilat pastrohen nga Ujërat dhe në këtë mënyre zhvendosen në një pjesë tjetër toke dhe në fund në rrjedhjet ujore.

Zona ku do zhvillohet aktiviteti eshte ne largesi nga zona me e afert e banuar. Mbetjet urbane qe do te krijohen nga aktiviteti i perditshem i punonjesve do et depozitohen ne kontenier plastik te vecante dhe me pas do te evadohen drejt venddepozitimeve te caktuara. Zonat e banuara ne afersi kane venddepozitimet e tyre per mbetjet urbane.

Pershkrim i karakteristikave sociale te zones ku propozohet projekti

- Njesia e qeverisjes vendore qe administron zonen ku zbatohet projekti

Zona ku do te shfrytezohe per nxjerrjen e gurit gelqerore ndodhet ne fshatin Herraj, Njesia Administrative Zall Herr, Bashkia Tirane

- popullsia dhe aktivitetet kryesore ekonomike te zones

Zona ku do te shfrytezohe per nxjerrjen e gurit gelqerore ndodhet ne fshatin Herraj , Njesia Administrative Zall Herr , Qarku Tirane.

Nga pikpamja gjeografike terreni ku shtrihet objekti per shfrytezim, duke qene se ben pjese ne zonen kodrinore malore ne qendrore se vendit tone, eshte terren kodrinoro malor , i nderthurur ndermjet pjeses fushore kodrinore dhe asaj malore , lartesite e te cilave eshte me e madhe se 340m deri 500 m mbi nivelin e detit Objekti shtrihet nga kuota me e poshtme prej +340 m deri ne ate te siperme prej +495 m. vete

Objekti ben pjese ne zonen shkembore gelqerore qe quhet shpati i Herrajit dhe shtrihet ne Lindje te ketij fshati. Vete terreni ku zhvillon aktivitetin leja minerare eshte pak i aksidentuar dhe i shpelare nga erozioni dhe bimesi te ulet, shkure, barishte, etj.

Popullsia e kesaj zone i perket nje zone rurale dhe merret kryesisht me pune bujqesore, blegtorale dhe nje pjese e vogel eshte e punesuar ne objekte te ndryshme minerare qe jane ne aktivitet ne kete zone. Ata banojne ne fshatrat perreth si; Herra, Zall Herr dhe Priske e Vogel. etj dhe bejne pjese ne njesite administrative Zall Herr , si pjese perberse te Bashkise Tirane.

Kulturat kryesore qe kultivohen ne kete rajon jane Ulliri, kumbulla gruri, patatja, misri, lule dielli, jonxha etj. Vlen te theksohet se rendimentet, qe merren nga toka jane mjaft te larta. Gjithë toka është mjaft e sistemuar dhe e ndërprere nga një rrjet i dendur kanalesh vaditëse kulluese.

5. NJE PERSHKRIM TE NDIKIMEVE NEGATIVE TE RENDESISHME TE PROJEKTIT TE PROPOZUAR MBI MJEDISIN KU PERFSHIHEN

5.1 Ndikimet negative ne mjedis

- ndikimet negative ne karakteristikat fizike te zones se projektit

Siperfaqja ne te cilen do te behet shfrytezimi nuk duket nga qendrat e medha te banuara , me perjashtim te rasteve te kalimtareve qe udhetojne ne rrugen prane.

Duhet theksuar se siperfaqja qe do te shfrytezohet eshte kurrizore kodre . Aktiviteti shfrytezimit me kariere prek perkohesisht peizazhin ekzistues dhe topografine e saj per gjate kryerjes se aktivitetit .

Me masat qe do merren per rehabilitimin e saj, gjelberimin me bime qe rriten ne zone, gjate shfrytezimit dhe ne mbyllje te aktivitetit , peizazhi dhe topografia e zones do te permiresohet dukshem do te krijohet nje ambjent panoramik i kendshem per syrin e njeriut dhe çlodhes.

Dëmtimi i vegjetacionit bimor, sidomos gjatë hapjes se karrieres dhe shfrytezimit te shkalles se pare dhe te dyte është faktor negativ.

Shfrytezimi gurit gelqerore do te behet me kariere nga larte poshte me lartesi shkalle shfrytezimi 10m, dhe gjeresi sheshi shkalle ne mbyllje te aktivitetit 4 m qe do te pyllezohet.

- ndikimet negative ne habitatet dhe biodiversitetin e zones se projektit

Siperfaqja ne te cilen do te behet shfrytezimi nuk duket nga qendrat e medha te banuara , me perjashtim te rasteve te kalimtareve qe udhetojne ne rrugen prane. Objekti i kerkuar ndodhet rreth 200m ne veri Veri Perendim te rruges automobilistike Zall Herr Ujembledhesi i Bovilles dhe ne krah te majte te rruges rurale qe shkon ne fshatin Herra dhe lidhet me te me nje degezim te ndertuar vitet e fundit per qellime agrikulturale dhe shfrytezimin e karrieres . Ajo eshte rruge ne gjendje te mire, e shtruar. Kjo rruge i jep objektit mundesine e lidhjes me rrugen Zall Herr Boville dhe me fshatrat e tjere te zones perreth objektit.

Duhet theksuar se siperfaqja qe do te shfrytezohet eshte kodrinore-malore. Aktiviteti shfrytezimit me kariere prek perkohesisht peizazhin ekzistues dhe topografine e saj per gjate kryerjes se aktivitetit .

Shoqeria IN CO shpk

Me masat qe do merren per rehabilitimin e saj, gjelberimin me bime qe rriten ne zone, gjate shfrytezimit dhe ne mbyllje te aktivitetit , peizazhi dhe topografia e zones do te permiresohet dukshem do te krijohet nje ambjent panoramik i kendshem per syrin e njeriut dhe shlodhes.

Dëmtimi i vegetacionit bimor, sidomos gjatë hapjes se karieres dhe shfrytezimit te shkalles se pare dhe te dyte është faktor negativ.

Zona qe do te shfrytezohet nuk ka bimesi te larte eshte plotesisht e zhveshur dhe ne vende shume te vogla e mbuluar me bush dhe driza ku lartesia nuk i kalon 0.5m dhe ne vende te vecanta eshte shfaqje shkembore.

Nga ky aktivitet nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuar e percaktuar ne VKM nr. 804. dt. 4.12.2003 dhe e listuar ne urdherin e Ministrit nr. 146,dt.8.5.2007 Nga subjekti ne zbatim te projektit do te merren masa qe zona ne shfrytezim te jete gjithmone e kufizuar dhe te rehabilitohet duke u pyllzuar. Ndersa per te menjanuar errozionin nga ujerat e rreshjeve atmosferike ne skarpaten e siperme te shkalleve do te ndertohen kanale dhe kuneta qe ujerat te drejtohen ne zona qe nuk demtojne token, gjithashtu sheshet e shkalleve te karieres do te hapen me pjerresi nga skarpata e shkalles qe ujerat te rrjedhin ne drejtimin e duhur.

Zona e kerkuar per shfrytezim nuk përfaqëson zone me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për “Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundëshme” për tu shpallur “Peizazh i mbrojtur”.

- Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi i mbetjeve

Zhvillimi i aktivitetit nuk ka shkarkime ndotese ne toke, ne vendet e caktuara ne projekt (depozitat e sterileve) parashikohet depozitimi i materialit te paperdorshem dhe perpunimi i tij me toke vegetale per te mundesuar mbjelljen e bimeve dhe pemeve karakteristike te zones gjate fazes se rehabilitimit. Dherat e depozituara ne damba nuk permbajne elemente kimik ndotes per token, do te perpunohen me dhera te pasuruara me humuse, do te transportohen dhe shperndahen ne sheshet e shkalleve me trashesi mbi 20 cm dhe do te pyllzohen me bime qe rriten ne zone per gjelberimin e saj. Gjithashtu mbetjet e krijuara ne kariere nga veprimtaria humane e punonjesve ose nga proceset e punes do te trasportohen ne sheshin e depozitimit te miratuar nga pushteti vendor ose ne territorin e karieres dhe do te riciklohen ne mbyllje te aktivitetit per rehabilitimin e karieres.

- ndikimet negative shtese (kumulative) ne cilesine e mjedisit ne zonen e projektit dhe burimet natyrore si mineralet, pyje, burimet ujore.

Gjate fazes normale te operimit te projektit nuk do te kete emetime te gazeve, lengjeve, mbetjeve toksike, helme te ndryshme dhe substanca te tjera te demshme, te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e punonjesve, banoreve dhe mjedisin perreth, floren dhe faunen e zones, burimet ujore. Shfrytezimi gurit gelqeror pllake trashe me kariere eshte nje proces i thjeshte

Shoqeria IN CO shpk

pune me prerje te blloqeve, ngarkim te prodhimit me eskavator dhe transport me kamione. Meqenese nuk do te perdoren ne procesin e shfrytezimit lende te demshme, nuk do te kete shkarkime te lendeve kimike te demshme per mjedisin ne ajer, toke dhe uje. Siperfaqja qe do t'i nenshtrohet shfrytezimit nuk eshte toke bujqesore produktive. Ushtrimi i aktivitetit ne kete siperfaqe nuk ndikon negativisht ne cilesine dhe sasine e tokes bujqesore. Tokat bujqesore ndodhen jasht zones ku do te kryhet aktiviteti.

- ndikimet sociale te projektit te tilla si ndryshimi i perdorimit te tokes dhe shqetesimet qe mund te lindin nga ndikimet ne mjedis te projektit (si zhurmat, pluhuri, perdorimi i burimeve natyrore etj)

Ky aktivitet do te kryhet larg zonave te banuara, ne shpatin e kodres me depozitime gjeologjike te gurit gelqeror. Zbatimi projektit nuk kerkon ndryshime ne popullsi, spostime te zonave te banuara ose krijimin e zonave te reja banimi, etj. Aktiviteti i shfrytezimit te vendburimit do te behet ne nje zone te kufizuar ne krahasim me siperfaqen dhe popullsine e rajonit. Per zhvillimin e aktivitetit nuk do perdoret toke shtese vec asaj te miratuar per shfrytezim.

Zhurmat ne fazen e ndertimit kryesisht vijne :

- nga makinerit e perdorura per pastrimin e dheut te sheshit
- nga makinerit qe do perdoren per pergatitjen e shesheve te shkalleve te shfrytezimit te karieres.

Gjate fazes se pare te ndertimit paisjet e perdorura do te jene nje eskavator qe do te hap shkallet e karieres.

Ndikimi nga zhurmat ne fazen funksionale te aktivitetit

Burimet e zhurmave jane ne siperfaqe. Çdo burim perhap vale zhurme. Fusha akustike qe rezulton varet nga karakteristikat e absorbimit dhe reflektimeve te te gjitha pengesave ekzistuese, ndermjet burimit dhe receptorit.

Energjia zvoglohet per gjate rruges si rezultat i absorbimit te siperfaqeve, divergjences gjeometrike dhe absorbimit atmosferik.

- ne varesi te natyres te projektit nje pershkrim i aksidenteve te mundshme me pasoja ne mjedis

Rreziqe me pasoja ne mjedis

1. Demtim habitatesh dhe fole speciesh ne zonen ku do te kryhet shfrytezimi.
2. Renien e ndonje zjarri ne ambjentin e zones se shfrytezimit.

Rreziqet me pasoja ne mjedisin human dhe ekonomik

- Aksidentet e punonjesve gjate procesit teknologjik ne objekt.
- Aksidentet si pasoje e renies se zjarrit.

Probabiliteti i ndodhjes per secilin nga rastet e me siperm do te varet shume nga masat mbrojtese qe do te parashikohen dhe zbatohen. Zhvillimi i aktivitetit nuk shoqerohet me aksidente te cilat mund te sjellin pasoja te demshme ne mjedis si ndotje te ujerave nga lende te rrezikshme, emetime ne ajer nga gaze helmuese apo kontaminim te tokes. Shfrytezimi i burimit

natyror per nxjerrjen e gurit gelqeror do te behet sipas projektit dhe ne sasine dhe kohen e parashikuar.

5.2 Karakteristikat e ndikimeve negative ne mjedis

- metoda e zbatuar per parashikimin e ndikimeve negative ne mjedis

Per vleresimin e ndikimeve ne mjedis te projektit u ndoqen hapat e me poshteme:

-Njohja me projektin dhe teknologjine e tij.

-Njohja me natyren e operacioneve te nevojshme ne mjedis.

-Njohja me vleren natyrore dhe mjedisore te zones dhe siperfaqes qe do te shfrytezohet.

-Njohja me infrastrukturen egzistuese dhe nevojten per infrastrukture te re per projektin.

-Njohja me lendet e para qe do te perdoren per zbatimin e projektit.

Duke njohur teknologjine, operacionet ne terren dhe menyren e shfrytezimit te objektit u indetifikuan ndikimet e mundeshme negative ne çdo receptore - perberes te mjedisit ne objekt.

Indetifikimi i ndikimeve – Permes te cilit u percaktua nderveprimi mjedis-projekt i prodhimit te gurit gelqerore ne vendburim dhe u indetifikuan ndikimet e mundeshme gjate kesaj faze sipas receptoreve te mjedisit.

Vleresimi i ndikimeve – Ekspertet mjedisore te fushave te ndryshme bene perpjekje per matjen e gravitetit te ndikimeve . Vleresimi i Sinjifikances ka te beje me vete rendesine e ndikimeve dhe eshte faza me e rendesishme per zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe parafron ate me objektivisht me teresine e bashkeveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e perdorur per vleresimin e rendesise se ndikimeve variojne dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit te ndikuar.

- shtrirja fizike dhe kohezgjatja e ndikimeve te identifikuar (Shkalla)

Shtrirja fizike- Vlereson siperfaqen apo dimesionin hapsinore te nje ndikimi te dhene ne raport me burimin qe gjeneron ate ndikim, p.sh. ndikimi ne toke nga shfrytezimi eshte nje ndikim saktesisht i percaktuar i cili mund te matet , por ne se do te ket erozion te tokes ndikimi rritet ne permasa fizike te siperfaqes se marre per studim.

- **Kohezgjatja e ndikimit** – Vlereson se sa do te zgjase nje ndikim i caktuar ne dimesionin kohe (ndikim i perhershem apo i perkoshem). Ne rastin tone shfrytezimi i gurit gelqerore eshte e perhereshme per nje periudhe qe do perktoj me afatin e lejes minerare. Ndersa te gjitha ndikimet e tjera negative ne mjedis jane te perkoshme, si shkarkimet e ujit te rreshjeve, gjelberimit , etj

-Kthyesmeria –Vlereson mundesin e kthimit te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e tij te me pareshme (aftesia per tu rehabilituar dhe regjeneruar)

-Rendesia – Realizon nje vleresim total te tre permasave te mesiperme dhe njekohesisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit.

Ndikimet e parashikuara nuk kane shtrirje te madhe fizike, objekti i shfrytezimit ndodhet ne distance te konsiderueshme nga zona me e afert e banuar dhe nuk preket nga zhvillimi i ketij aktivitetit. Zhurmat qe krijohen gjate hapjes dhe shfrytezimit te shkalleve te karieres nuk perbejn

Shoqeria IN CO shpk

ndotje akustike. Analiza e frekuences te zhurmes te emetuar nga keto makineri dhe pajisje tregon se ato ndodhen nen mesataren e frekuences 100 – 150 Hz , e cila eshte e pranueshme nga veshi i njeriut . Koha ne te cilen do te jene te pranishme keto zhurma eshte vetem gjate dites, meqenese ne objekt do punohet vetem me nje turn. Niveli i zhurmave te ketyre mjeteve ne largesi nuk do te jete i madh dhe do te jete konform normave ne fuqi.

- lloji i ndikimeve te identifikuara (direkte dhe jodirekte)

Ndikimet e identifikuara nga zhvillimi i aktivitetit jane ndikime direkte ne mjedis.

Tabela e indetifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne toke.

	Ndikimi i mundshem	Sqarim
1	Derdhja pa dashje e vajrave dhe lubrifikanteve nga mjetet e punes.	Behet fjale per ndonje rast te rralle te rrjedhjes gjate difekteve dhe çarje te tubave dhe sotokartit te mjeteve motorike dhe nderrimit te vajrave ne makinerite e karrieres gjate prodhimit dhe transportit te gurit gelqeror .

Tabela e indetifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne ajer.

	Ndikimi i mundshem	Sqarim
1	Shkarkimi i gazeve ne sasi minimale nga lenda djegese	Sasia e gazeve nga djegia e karburantit qe do te shkarkohet nga mjetet motorike. Eshte standart i teknologjise se prodhimit te mjeteve dhe i karburantit.
2	Emetimi i zhurmave nga puna e makinerive te karrieres.	Vlerat standart te emetimit te zhurmave sipas teknologjise se prodhimit te makinerive, kontroll teknik te makinerive te karrieres..

Tabela e indetifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne biodiversitet.

	Ndikimi i mundshem	Sqarim
1	Shqetesim i mundshem i faunes.	Ndikim i perkoshem.

- mundesia e zbutjes se ndikimeve dhe argumentimet perkatese nese per ndikime te caktuara nuk mund te zbatohen/ ndermerren masa zbutese

Per te ulur ne minimum ndikimet nga zhurmat do te merren keto masa:

- Makinerit e shpimit, te ngarkimit dhe transportit te gurit gelqerore do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore, te pajisura ne marmita silenciatore te pakesimit te zhurmave.
- Per te ulur me tej ndikimin nga zhurmat puntoret detyrimisht do te perdorin paisjet e mbrojtjes ne pune “kufje”

Brenda zones karrieres vlerat e zhurmave jane gjithmone poshte normave te lejuara. Jane bere matje te nivelit te zhurmave ne disa objekte te ngjashme ku perdoren te njejtat makineri dhe del

se ne distancen 10m nga makinerit zhurmat arrijne nivelin 70 dB.

Emetimet ne ajer perfaqsohen nga pluhuri qe krijohet gjate shpimit te birave per pykat zgjeruese per ndarjen e bllokut, ngarkimit, shkarkimit te gurit gelqeror, levizjes se makinerive ne territorin e karrieres ndersa ndikimi nga gazet shkaktohet nga mjetet motorrike, eskavatoret, fadromat, kamionet dhe mjetet e tjera motorrike qe levizin ne karriere.

Me projekt per mbrojtjen nga pluhuri do te merren keto masa.

Per te eliminuar pluhurin qe krijohet gjate ngarkimit te gurit gelqerore, transportit dhe levizjes se mjeteve ne shkallet e karrieres, materiali qe ngarkohet dhe sheshet e shkalleve do te lagen me uje, ndersa makinat do te mbulohen me mushama.

Per mbrojtjen nga gazet e motorreve dizel do te merren keto masa.

Mjetet motorrike do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore.

Ato do te jene te pajisura ne marmita me katalizatore per kapjen e gazeve toksike.

Meqenese qendrat e banuara jane ne nje distance relativisht te larget nga zona e shfrytezimit, keto emetime nuk ndikojne ne to.

Gjithashtu nuk do te kete ndikim tek punonjesit e karrieres, floren dhe faunen per rreth saj.

Per zbutjen e ketyre ndikimeve mbi punonjesit e karrieres ata do te pajisen me mjete mbrojtese nga pluhuri dhe gazet.

6. NDIKIMET NE MJEDISIN NDERKUFITAR TE PROJEKTIT (NESE KA TE TILLA)

Objekti eshte ne brendesi te territorit te vendit dhe nuk ka ndikime nderkufitare.

7. NDIKIMET POZITIVE NE MJEDISIN E ZONES SE PROJEKTIT

Per sa i perket ndikimeve pozitive ne mjedisin e zones se karrieres se gurit gelqerore ato jane si me poshte

-Shfrytezimi i lendes se pare qe jane guri gelqeror qe do perdoren per prodhim inertesh.

-Ndertimi i infrastruktures rrugore e cila do te perdoret nga banoret e zones.

-Zona qe ishte e zhveshur do te pyllzohet per rreth objektit dhe do te ndikoj ne rregullimin e peizazhit

-Do te punsohen disa punonjes ne objekt do te permirohet kushtet e jeteses se punonjesve te zones

-Do te shtojte prodhimin e inerteve te gurit gelqerore i cili eshte nje mineral i rendesishem ne industrine e ndertimit ne rang kombetare dhe do te zbus nevojat per kete lende te pare qe jane shume te medhaja.

8. MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT NGA SECILI NDIKIM NEGATIV I IDENTIFIKUAR

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate punimeve, ne ajer, te pluhurave dhe zhurmave, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore te territorit , faunen dhe floren. Por pikesynimi i studimit mbetet rehabilitimi i tokes dhe evitimi ne maksimum i erozionit.

Identifikimi i masave per te eleminuar apo zbutur ndikimet negative ne mjedis

a. Planifikimi i zones

Per shmangien dhe parandalimin e erozionit si dhe per ruajtjen e regjimit te rrymes se ujit te parametrave hidrodinamike te saj, ne projekt eshte percaktuar shfrytezimi harmonik dhe i kombinuar ne kohe dhe hapësire i zones ne teresi .

Ne zonen e shfrytezimit hap pas hapi dhe ne perfundim te aktivitetit, eshte parashikuar mbushja , sistemimi, perpunimi dhe mbulimi i siperfaqeve te shfrytezuar.

Kjo siperfaqe e perftuar nga trajtimet e mesiperme, do te jape mundesi per rikultivimin e bimeve dhe pemeve te ndryshme, duke krijuar njeheresh kushte per parandalimin e erozionit dhe permiresimin e pamjes se pergjithshme te zones se shfrytezuar.

Duhet theksuar se siperfaqja e caktuar per shfrytezim eshte e vogel dhe nuk perben ndonje ndikim ne zone.

b. Masat teknike

Per parandalimin e erozionit subjekti parashikon ne nje vit te kryeje punimet e meposhtme

Dhenia e pjerresise shkalleve te karrieres me pjerresi ne drejtim te zones se shfrytezimit.

Ndertimin e kunetave ne skarpatat e siperme te shkalleve per disiplinimin e ujrave

Mbjellje para se te filloje shfrytezimi te te gjitha periferive te tjera me peme karakteristike te zones per te izoluar pjesen e fragmentizuar nga shfrytezimi i pjeseve te paprekura nga projekti, mbjellja do te behet duke marre mendimin e specialisteve te sherbimit pyjore Tirane .Keto masa do te sherbejne per mbrojtjen nga pluhurin qe mund te nxitet nga aktiviteti gjate shfrytezimit.

Uljen e intensitetit te shfrytezimit per stinen e veres duke evituar keshtu sa te jete e mundur errozionin dhe pluhurat. Nga ana tjetere per te ulur efektet erodive gjate periudhave te thata do te perdoret lagia e terreneve nen pune dhe lagia e vendgumbullimit te materialit te nxjerre. Kjo do te evitoje edhe ndotjen gjate transportit.

Per rritjen e efektivitetit ekonomiko-ekologjik per te gjitha veprimet konkrete do te merren masa mbikqyrese nga Drejtoria e Sherbimit Pyjor Tirane si dhe Specialist te mjedisit.

Zhurmat

Zhurmat qe krijohen vijne nga levizja e makinerive, jane te pranishme por nuk perbejn rrezik dhe shqetesim per mjedisin sepse zonat e banuara jane ne nje distance te konsiderueshme. Per mbrojtjen nga zhurma te njerezve nga ana e shoqerise do te punohet ne dy drejtime

- Ne karriere do te perdoren makineri dhe pajisje te teknologjise se larte te pajisura me amortizues te zhurmave
- Punonjesit do te pajisen me mjete mbrojtese nga zhurmat sipas rregullores se sigurimit teknik. Niveli i zhurmave nga Perdorimi i makinerive te teknologjise se larte dhe i metodave te perparuara ne ngarkim dhe transport te inerteve do te jete brenda normave te lejuara.

Rreziku ne shendet dhe masat per zbutjen e tij

Rreziku ne mjedis ne shfrytezimin e karrieres eshte prezent ne proceset e rrezimit te gurit gelqerore, ngarkimin dhe transportit te tij.

Drejtuesi teknik i karrieres duhet te jete Ing. Miniere i cili duhet te beje vazhdimisht instruksionin teknik te punetoreve dhe ne vecanti te drejtuesve te mjeteve motorrike.

Shoqeria IN CO shpk

Ne objektet minerare te shfrytezimit te gurit gelqerore me karriere, punonjesit instruktoret teorikisht dhe ne praktik jo me pak se dy jave ne vendin e tyre te punes, mbi aksidentet e mundshme dhe masat mbrojtese ne pune. Gjate instruktimit do te punohet ne mbikqyrje te instruktorit jo me pak se nje jave ne te gjitha proceset e punes.

Per mbrojtjen nga zhurmat, punonjesit e karrieres do te perdorin kufje. Gjithashtu do te perdore uniformen e punes, doreza, cizme ose kepuce te certifikuara per aktivite prodhimi industrial ne karriera. Per reagimin e menjehershem ndaj aksidenteve te mundshem humane, karriera do te kete edhe nje ambient te mbyllur ambulance ku do te mbahet kutia e ndihmes se shpejte ne rast aksidenti ose demtim shendeti te njerezve.

Rreziqet nga aksidentet e mundshme ne pune dhe masat per te parandaluar aksidentet dhe minimizuar pasojat.

Kryerja e veprimtarise minerare per prodhimin e mineralit te gurit gelqeror disiplinohet me projektin teknik e teknologjik te shfrytezimit te hartuar per marrjen e lejes se shfrytezimit . Ne projekt jane parashikuar masat teknike dhe organizative per parandalimin e aksidenteve te mundshme ne mjedis te veprimtarise dhe minimizuar pasojat ne mjedis.

Jane percaktuar kerkesat e sigurimit teknik qe do te zbatohen nga drejtuesit e aktivitetit dhe nga vet punonjesit e prodhimit.

9. PROGRAMIN E MONITORIMIT TE NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTT

Subjekti do te monitoroje aktivitetin e prodhimit te gurit gelqerore me karriere ne disa drejtime sipas nje programi te hartuar per kete qellim. Ne pergatitjen e programit te monitorimit mjedisor merret ne konsiderate mundesia e realizimit te nje monitorimi te elementeve me ndikim ne mjedis. Vetemonitorimi aktivitetit nga subjekti do te behet per ata elemente qe parashikohet se kane ndikim negativ ne mjedis. Te dhenat e marra nga monitorimi do te evidentohen ne regjistrin perkates dhe me rezultatat e matjeve do te informohen organet e administrimit te mjedisit ne qender dhe ne qark. Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vete kompania dhe do te dorezohen ne DRM-ne e qarkut perkates sa here eshte e nevojshme, sipas procedurave ligjore dhe rregullore.

Masat qe rekomandohen ne monitorim:

- Inspektimi i zones per te kontrolluar shendetin e vegjetacionit.
- Kontrollin e erozionit.
- Demtim nga kullotja e kafsheve si shtepiake dhe ato te egra.

Me VKM per programin e monitorimit jepen qarte indikatorët mjedisor qe monitorohen, megjithate keta indikator duhet te pershtaten dhe ti perkasin veprimtarise.

Qellimi i monitorimit mjedisor per veprimtarine e projektit te zbatuar eshte qe te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet ne se operimi i veprimtarise eshte ne perputhje me ligjet dhe standartet mjedisore qe lidhen me te, si dhe per te vleresuar performancën mjedisore te menaxhimit te saj ne kuader te permiresimit te vazhdueshem.

10. PLANI I MENAXHIMIT

Permbledhje Joteknike e VNM

Shoqeria IN CO shpk

- rolet dhe pergjegjesit per zbatimin e seciles mase te propozuara per mbrojtjen e mjedisit ne secilen faze te projektit

Problemet e gjenerimit te mbetjeve dhe administrimit te tyre jane minimale. Mbi depozitimin e mineralit te gurit gelqerore ne pergjithesi nuk ka mbules dherash por dalin direkt ne siperfaqe Mbetjet e krijuara gjate shfrytezimit do te perdoren si stabilizant per shtrim rruges. Gjithe prodhimi ne kariere do te jete i perdorshem.

Mbetjet urbane hidhen kryesisht ne vende te caktuara per kete qellim. Grumbullimi dhe heqja e mbetjeve dhe sistemimi i mbetjeve sterile eshte pergjegjesi e prodhuesit.

Veprimtaria e shfrytezimit te gurit gelqerore eshte veprimtari minerare. Ajo do te zbatohet me punime siperfaqesore, kariere. Si rezultat i kesaj veprimtarie prodhohet gur gelqerore per inerte.

Per te shfrytezuar gure gelqerorin me kariere hapet vendburimi me elementet e saj, rruget, gjysem transhete dhe shkallet e karieres.

Te gjitha keto punime minerare hapen ne shkembinjte gure gelqeror.

Mbetjet qe gjenerohen gjate hapjes se rrugeve, gjysem transheve, shkalleve per zbulimin dhe nxjerrjen e mineralit jane lende e pare per perdorim.

Keto mbetje jane objekt i ligjit Nr 10304, date 15.07.2010 "Per sektorin minerar Shqiptar" dhe veçanerisht udhezimet Nr.3 date 17.05.2006 "Per planet e rehabilitimit te siperfaqeve te demtuara nga aktiviteti minerar"

Per te plotesuar kerkesat e ketij udhezimi eshte hartuar plani i rehabilitimit te karieres dhe mbetjeve minerare te gjeneruara nga veprimtaria minerare nga kjo kariere.

Per te shmangur dhe menaxhuar sa me mire ndikimet negative ne mjedis te shkaktuara nga elementet e pershkruar me siper, subjekti nepermjet personelit te tij harton dhe zbaton nje plan efikas menaxhimi te ndikimit ne mjedis. Ne perpilimin e Planit te Menaxhimit dhe analizimin e tij eshte vrejtur se realizimi me sukses i ketij plani sjell nje sere perfitimesh per shoqerine te tilla si: ushtrimi i veprimtarise ne perputhje me ligjet dhe rregulloret, mardhenie te mira me publikun dhe ambientalistet, shmangia e penaliteteve nga organet e kontrollit te mjedisit etj.

Parimet e zbatueshme te programit te menaxhimit te elementeve me ndikim ne mjedis jane paraqitur me poshte nga ana e stafit drejtues i konsultuar me stafe inxhinerike dhe drejtues te objektit. Detajimi i parandalimit, kontrollit dhe nderhyrjeve te stafit te linjes ne elementet e veçante dhe delikate sipas nje tablele te kuadrit logjik eshte mjaft domethenes per inisjativen dhe pergjegjesine.

Materiali i pergatitur nga

STUDIO PROJEKT shpk

Ekspert Mjedisi Ing. Mirete Xhevair DERMIS

Ing. Mjedisi

Arvena FEJZULLAI

Ing. Pyjesh

Gerti BRAHIMI



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT**

Nr. 331 Prot.

Tirane, me 09.09. 2004

Vendimi Nr.11, Nr.086Regj.

ÇERTIFIKATË


Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.268, datë 24.04.2003 "Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Xhevair DERMYSHI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Ethem RUKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Zhvillimit Ekonomik,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes

LICENCË



LN-0042-06-2009	NUIS/NIPT: K620210015
Subjekti: STUDIOPROJEKT	
Adresa: TIRANE, TIRANE, TIRANE, Rruga Frosina Plaku (Perballë Klubi Partizani), 51/6	
Kodi: III.2.A (1+2)	Kod tjetër:
Data e lëshimit: 27/03/2014	Afati i vlefshmërisë: Pa afat
Kategoria	
Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis	
Nënkategoria	
Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis	
Veprimtari specifike	
1. Ndikim në mjedis 2. Auditim mjedisor	
Specialiteti	

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor, vlerësimi i ndikimit në mjedis)

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nënskrimi i sportelit:

Dajana Steja

